

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E ENJTE 14 PRILL 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

E kërkova fjalën për një ndërhyrje të shkurtër, sepse më duhet të sqaroj një lajm, i cili është bërë publik ditën e djeshme, madje është komentuar edhe nga përfaqësues të opozitës. Lajmi lidhet me renditjen e universiteteve shqiptare, bazuar në përmbajtjen e faqeve të internetit. Kjo është iniciativë e një grupi kërkimor spanjoll, që quhet Cybermetrics Lab, i cili ka për qëllim analizën sasiore të përmbajtjes së publikimeve të faqeve të internetit të universiteteve. Pra, të dhënat që merr ky grup kërkimor për të bërë analizën e tij, merren në mënyrë të pavarur nga faqet e internetit të çdo universiteti dhe jo nëpërmjet komunikimit apo bashkëpunimit me vetë universitetet, apo me institucionet e tjera zyrtare shqiptare apo të huaja.

Qëllimi kryesor është t'i motivojë universitetet, kërkuesit dhe studiuesit, që të jenë sa më aktivë dhe të pranishëm në faqet online të institucioneve të tyre. Kjo do të thotë që, nëse një universitet ka një pozicion jo të kënaqshëm në këtë renditje në raport me cilësinë e tij akademike, atëherë, kjo do të thotë që universitetet duhet të rishikojnë politikën e tyre të paraqitjes së informacioneve apo të publikimeve të tyre. Pra, strategjia më e mirë për të përmirësuar renditjen apo pozicionin në këtë renditje, është që universitetet të pasqyrojnë sa më shumë informacion edhe për nga sasia, por edhe për nga cilësia. I përmenda këto jo sepse ky rankim nuk vlen, natyrisht që çdo renditje ka vlerë, por e rëndësishme është që ta lexojmë siç duhet dhe të nxjerrim mësimet që duhen. Universitetet shqiptare padyshim duhet të jenë më aktive, duhet të jenë më transparente, duhet të jenë më të pranishme në faqet e tyre të internetit. Nëse duhet t'i vlerësojmë universitetet shqiptare për sa i takon cilësisë, duhet t'i referohemi njëres prej 3 renditjeve zyrtare më të rëndësishme në të gjithë botën. Është fjala për renditjen e 400 universiteteve më të mira të Europës Qendrore, Lindore dhe të Azisë Qendrore.

Janë rreth 4000 universitete që analizohen dhe prej tyre përzgjidhen 400 universitetet më të mira. Për herë të parë, Shqipëria është përfaqësuar në renditjen më të mirë, pra, është pjesë e 400 universiteteve më të mira në vitin 2020, fillimisht me Universitetin e Tiranës, ndërkohë në vitin 2021 kishim 5 universitete. Edhe këtë vit jemi përsëri të konsoliduar me 3 universitete, Universiteti i Tiranës, Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universiteti "Epoka". Natyrisht, ne jemi të vetëdijshëm që kemi ende shumë punë për të bërë, për të rritur cilësinë e arsimit të lartë, cilësinë e universiteteve, por nuk mund t'i mohojmë hapat pozitivë që po bëhen. Ne, bashkë me universitetet, po punojmë për ndërkombëtarizim e tyre. Kush do ta imagjinonte para pak vitesh që universiteti La Sapienza do të lidhte një marrëveshje për një doktoraturë të përbashkët me Universitetin e Mjekësisë së Tiranës, apo që Universitetit Shtetëror i Miçiganit përsëri do të lidhte një marrëveshje me 5 universitete publike të Tiranës, apo që universiteti Bochum i Vjenës do të lidhte një marrëveshje binjakëzimi me Universitetin Bujqësor të Tiranës?

I përmend këto për të thënë, edhe një herë, që vërtet kemi shumë për të bërë, por janë bërë hapa shumë pozitivë. Kështu, ky diskutim i madh i këtyre dy ditëve të fundit në lidhje me rankimin e universiteteve në këtë renditje, që është vetëm për sa i takon përmbajtjes së faqes së interneti të universiteteve, dyshoj se është i qëllimshëm. Natyrisht, nuk mund të bëj akuza, por kam të drejtë të dyshoj që është i qëllimshëm sepse është pikërisht momenti kur maturantët tanë do të vendosin se ku do të kryejnë studimet e tyre, pasi do të zgjedhin universitetet. Natyrisht, ky është një moment kritik, pasi ne po punojmë shumë fort që t'i bindim të rinjtë dhe të rejat të zgjedhin edhe universitet shqiptare, sepse universitet shqiptare tashmë po rrisin cilësinë e tyre, po ngrihen në nivelin e universiteteve prestigjioze rajonale apo europiane dhe pikërisht në këtë moment hidhen gjithë këto akuza për cilësinë e universiteteve shqiptare. Mua kjo gjë më duket dashakeqëse. Natyrisht, të gjithë duhet të punojmë për të rritur cilësinë e universiteteve, por nga ana tjetër duhet t'i bëjmë të gjithë thirrje rinisë shqiptare, që të studiojë në Shqipëri, të jetojë në Shqipëri, të japë kontribut këtu. Faleminderit!